



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 80/2021 (JR)  
Nr. 80/2 regj.

Tiranë, më 30.01.2025

**SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e enjte, **datë 20.02.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 80/2021, datë 16.12.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit, z. Erion Çelaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 448, datë 21.09.2021.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësues, përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjyqësues**  
**Relator i Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**

**Ina Rama**  
**Sokol Çomo**  
**Natasha Mulaj**  
**Rezarta Schuetz**  
**Albana Shtylla**

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

**INA RAMA**  
  
